

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 8005  
E mërkurë, 5 mars 2025  
Çmimi 0.50 €

KQZ-ja pret që sot të përfundojë numërimi i votave | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## KURTI SHPËRFILL URDRIN E GJYKATËS THEMELORE, S'PARAQITET NË PROKURORI PËR DËSHMI | FAQE 4-5



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, përsëriti të martën se është i gatshëm të dëshmojë në rastin e rezervave shtetërore dhe i ftoi sërish hetuesit e Prokurorisë Speciale që të

shkojnë në zyrën e tij. Kurti i bëri komentet në Gjilan, ku mori pjesë në vendosjen e gurthemelit të një kopshti për fëmijë. Në kohën që ishte atje, përkatësisht në 10:00 të

paradites, ai ishte i ftuar të paraqitej në Prokurorinë Speciale të Kosovës, me urdhër nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Megjithatë, Kurti nuk u paraqit atje

### AKTUALE



OPOZITA LËSHON SËRISH BOMBA TYMI NË KUVENDIN E SERBISË | F. 2

REGJISTROHEN DISA RASTE ME FRUTH NË KOSOVË, IKSHPK-JA BËN THIRRJE TË VAKSINOHEN FËMIJËT | F. 7

PRISHTINA NIS DIGJITALIZIMIN E SHKOLLAVE | F. 6

### EKONOMI



VEPRIMI SEED + FORCON STRATEGJINË E MENAXHIMIT TË RREZIKUT DOGANOR TË CEFTA-S 2025-2028 NË PALERMO | F. 8

MAQEDONIA E VERIUT GJEN BAKTER NË NJË MOSTËR UJI NGA KOSOVA | F. 8

### SPORT



SONTE KATËR NDESHJE INTERESANTE NË LIGËN UNIKE | F. 6

### RUTTE DHE AMBASADORËT E NATO-S PRITET TA VIZITONË KOSOVËN | F. 6



### SONNY PLAYSTATION I GJYKATËS RACISTE SPECIALE | F. 3

REAGIM I KËSHILLIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Opozita lëshon sërish bomba tymi në Kuvendin e Serbisë

**BEOGRAD, 4 MARS** - Deputetët e opozitës në Serbi lëshuan të martën dy herë bomba tymi dhe aktivizuan mjete piroteknike në Kuvend. Deri te kjo erdhi pasi deputetët e koalicionit qeverisës miratuan rendin e ditës, të cilin opozita e kundërshtoi.

Deputetët opozitarë iu afruan tavolinës së kryetarit, aktivizuan bomba me tym të kuq dhe të zi dhe shpalosën një pankartë ku shkruhej "Serbia po ngrihet për ta rrëzuar regjimin".

Ekipi i "Radios Evropa e Lirë", i pranishëm në vendngjarje, raportoi se tymi nga mjetet piroteknike mund të nuhatej edhe në korridorët e Kuvendit. Pavarësisht tymit, kryetarja e Kuvendit, Ana Bërnabiq, ka refuzuar mbylljen e seancës dhe e ka akuzuar opozitën se

po vepron si "bandë terroriste". "Serbia nuk do të ndalet. Revolucioni juaj me ngjyra ka dështuar", ka thënë Bërnabiq në sallë.

Më pas, ministrat dhe deputetët e partive në pushtet kanë nisur të diskutojnë për pikat e agjendës.

Opozita i ka penguar ata duke bërë titur dhe, në një pikë, deputetët opozitarë kanë lëshuar prapë bomba tymi dhe kanë aktivizuar një fikës zjarri.

Paraprakisht, qeveria miratoi rendin e ditës me 62 pika, por refuzoi kërkesën e opozitës që të diskutohej vetëm për ndryshimet në Ligjin për Arsimin e Lartë. Këto të fundit janë kërkesa të studentëve që protestojnë në Serbi që nga shembja vdekjeprurëse e një strehe në Stacionin

Hekurudhor të Novi Sadit më 1 nëntor të vitit të kaluar.

Në seancë duhej të miratohej edhe dorëheqja e kryeministrit të Serbisë, Miloš Vučević, të cilën ai e ofroi më 28 janar, nën presionin e protestave të studentëve. "Ne konsiderojmë se qeveria ka rënë. Ju nuk keni të drejtë të propozoni ligje derisa jeni në dorëheqje. Ju duhet ta arrestoni veten dhe të mos bëni cirk", tha deputetja e Partisë për Liri dhe Drejtësi, Marinika Tepiq.

Disa deputetë të opozitës në sallë mbajtën edhe fotografi me duar të përgjakura dhe pankarta ku shkruhej: "Grevë e përgjithshme", "Studentët kanë të drejtë" dhe "Mësimdhënës, jemi me ju". Kërkesat e studentëve për ndalimin e bllokadave



përfshijnë publikimin e dokumentacionit të plotë për rindërtimin e Stacionit Hekurudhor të Novi Sadit, për ta përcaktuar përgjegjësinë për aksidentin e 1 nëntorit 2024. Ata, gjithashtu, kërkojnë që sulmuesit e demonstruesve nëpër Serbi, gjatë protestave

që pasuan aksidentin, të identifikohen dhe të përballesh me përgjegjësi penale.

Kërkesat përfshijnë edhe lirimin e aktivistëve të arrestuar gjatë protestave, ndalimin e procedurave penale kundër tyre, si dhe rritjen e buxhetit për universitetet.

## Trumpi pezullon ndihmën ushtarake për Ukrainën pas përplasjes me Zelenskyn

**KIEV, 4 MARS** - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, pezulloi gjithë ndihmën ushtarake për Ukrainën pas përplasjes së tij me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky javën e kaluar në Zyrën e Ovalit. "Ne po e ndalojmë dhe shqyrtojmë ndihmën tonë, për t'u siguruar se ajo i kontribuon zgjidhjes", tha një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë, në kushte anonimiteti. "Presidenti ka qenë i qartë se është i përqendruar në paqe. Ne kemi nevojë që partnerët tanë të përkushtohen ndaj këtij qëllimi", tha zyrtari.

"Bloomberg" dhe "Fox News" raportojnë se pauza do të zgjasë derisa Trumpi të përcaktojë se udhëheqësit e vendit janë të përkushtuar - me besim të mirë - ndaj paqes. "Kjo nuk është ndalesë e përhershme e ndihmës - është pauzë", citoi "Fox News" një zyrtar të administratës Trump. Sasia e saktë e ndihmës ushtarake që preket nga ky vendim nuk është e qartë, por



transferimi i armëve me vlerë 3.85 miliardë dollarë - i autorizuar nga Kongresi amerikan nën ish-presidentin Joe Biden - nuk është proceduar ende nga Shtëpia e Bardhë.

Ndonjë ndihmë e re ushtarake nuk është miratuar pasi Trumpi ka marrë detyrën në janar. Kongresi amerikan ka miratuar vlerën e më shumë se 180 miliardë dollarëve ndihma për Ukrainën prej se Rusia ka nisur

pushtimin e saj në shkallë të plotë në shkurt të vitit 2022. "Pezullimi i ndihmës së ShBA-së, para së gjithash, mund t'i prekë raketat e mbrojtjes ajrore, municionet HIMARS dhe artilerinë", shkroi ligjvënësi ukrainas Oleksiy Honcharenko në "Telegram".

Demokratët e dënuan menjëherë vendimin për pezullimin e ndihmave, duke e cilësuar të rrezikshëm dhe të paligjshëm. "Kolegët e mi

republikanë, të cilët e kanë quajtur [presidentin rus, Vladimir] Putin kriminel lufte dhe kanë premtuar mbështetjen e tyre të vazhdueshme për Ukrainën, duhet të bashkohen me mua dhe të kërkojnë që presidenti Trump të heqë dorë nga kjo ngjarje katastrofike dhe e paligjshme", tha përfaqësuesi demokrat Gregory Meeks.

Shtetet e Bashkuara, më herët, bënë trysni mbi Zelenskyn për t'u pajtuar me thirrjen e Uashingtonit për një marrëveshje që do t'u jepte fund luftimeve në Ukrainë, ndërkohë që udhëheqësit evropianë kërkojnë një rol më të fortë në këtë qëllim. Trumpi tha se durimi i tij është drejt fundit dhe kritikoi rezistencën e Zelenskyt ndaj perspektivës së një armëpushimi të shpejtë, pa garanci konkrete të sigurisë, që Kiev i kërkon nga Shtetet e Bashkuara.

Më 3 mars, Zelensky u citua të ketë thënë se fundi i luftës është

"shumë, shumë larg".

Trumpi shkroi në rrjetet sociale se "kjo është deklarata më e keqe që mund të ishte bërë nga Zelensky" dhe se "Amerika nuk do ta durojë për shumë kohë të gjatë".

Ai shtoi se Zelensky "nuk do që të ketë paqe për aq kohë sa e ka mbështetjen e Amerikës".

Ky postim në platformën "Truth Social" la të kuptohet se riparimi i lidhjeve me Shtëpinë e Bardhë - që udhëheqësit evropianë ia kërkojnë Zelenskyt ta bënte - do të jetë një detyrë e vështirë pas përplasjes në Zyrën e Ovalit më 28 shkurt.

Në atë takim, Trumpi dhe zëvendësi i tij, JD Vance, e qortuan ashpër Zelenskyn para gazetarëve.

Zelensky u largua nga Shtëpia e Bardhë pa nënshkruar marrëveshjen që do t'i jepte ShBA-së qasje në mineralet e rralla dhe burimet natyrore të Ukrainës, siç ishte e planifikuar. Që nga ajo ditë zyrtarët amerikanë i bënë thirrje Zelenskyt të kërkojë falje.

## Hyjnë në fuqi tarifat e ShBA-së kundër Kanadasë, Meksikës dhe Kinës

**WASHINGTON, 4 MARS** - Tarifat prej 25 %, të paralajmëruara nga presidenti i ShBA-së, Donald Trump, për importet nga Kanada dhe Meksika, hynë në fuqi të martën.

Trumpi tha se këto masa janë përgjigje ndaj fluksit të papranueshëm të drogave të paligjshme dhe imigrantëve pa dokumente në ShBA nga dy vendet fqinje. "Nuk ka më vend për Kanadanë dhe Meksikën", tha Trumpi në Shtëpinë e Bardhë.

Ai shtoi se e vetmja mënyrë për t'i shmangur tarifat do të ishte që prodhuesit kanadezë dhe meksikanë ta zhvendosnin prodhimin në ShBA. "Ata duhet t'i ndërtojnë fabrikat e tyre të makinave dhe fabrika të tjera këtu në Shtetet e Bashkuara. Në atë rast, nuk ka tarifa", tha Trumpi.

Tarifa shtesë prej 10 % iu vendosën edhe importeve nga Kina, pas akuzave se Pekini nuk po bën mjaftueshëm për ta ndaluar rrjedhën e fentanilit

në ShBA.

Kjo masë i çoi tarifat totale për produktet kineze në 20 %. Kanadaja tha se do të hakmerret me tarifa prej 25 % për disa mallra amerikane me vlerë 150 miliardë dollarë, ndërsa Meksika dhe Kina paralajmëruan, gjithashtu, kundërmasa. "Tarifat tona do të mbeten në fuqi derisa ShBA-ja të mos zbrapset nga ky veprim tregtar", tha kryeministri kanadez Justin Trudeau.



# Rutte dhe ambasadorët e NATO-s pritet ta vizitojnë Kosovën

PRISHTINË, 4 MARS - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, pritet ta vizitojë Kosovën më 11 mars, për herë të parë që kur e mori këtë pozitë. Këtë e ka mësuar "Radio Evropa e Lirë" nga burimet diplomatike.

Një ditë më herët shefi i NATO-s do ta vizitojë Bosnjë-Hercegovinën.

Gjatë vizitës në Kosovë pritet që Rutte të jetë i shoqëruar edhe nga ambasadorët e vendeve anëtare të NATO-s që janë anëtarë të Këshillit të Atlantikut të Veriut.

NATO-ja ende nuk e ka paralajmëruar zyrtarisht një vizitë të tillë.

Vetë Rutte kishte paralajmëruar se do ta vizitonte Kosovën gjatë muajit mars në një debat që kishte pasur më herët në Bratisllavë të Sllovakisë.

Rutte të hënën ka pasur edhe një bisedë telefonike me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, para disa ditësh kishte thënë se stabiliteti në Kosovë, në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Serbi është në interes të të gjithëve dhe se ai nuk sheh arsye të besojë se mund të ketë ndonjë ndryshim dramatik sa i përket përkushtimit amerikan në NATO.

Ai këtë e kishte thënë gjatë

qëndrimit në Bratisllavë të Sllovakisë kur u pyet në një debat nga studentët se a sheh mundësi për rifillim të konfliktit në Kosovë pasi ka zëra se politika e re amerikane mund të çojë deri te largimi ushtarak. "Më lejoni të jem krejtësisht i qartë. Nga krejt ajo çka unë po kuptoj nga sistemi amerikan, është se ata janë plotësisht të përkushtuar ndaj NATO-s dhe angazhimeve aktuale. Por, le të shohim se çfarë do të ndodhë. Ne gjithmonë mund të kemi ndryshime të politikave ose adaptime të vogla që mund të ndodhin.

Sllovakët, holandezët dhe të tjerët po e bëjnë këtë. Por, nuk kam arsye të besoj se do të ketë vendime dramatike. Dhe, në përgjithësi, në Ballkanin Perëndimor, duhet të jemi të sigurt që ne e mbajmë në fokus këtë rajon, sepse stabiliteti në Kosovë, stabiliteti në Bosnjë dhe stabiliteti në Serbi është në interesin e të gjithë neve", ishte përgjigjur ai.

Edhe Rutte pas zgjedhjeve në Kosovë kishte bërë ftesë që të vazhdojë procesi demokratik, pjesë e të cilit është edhe formimi i koalicioneve.

Delegacioni i NATO-s, i kryesuar nga sekretari i përgjithshëm, Rutte, do ta vizitojë edhe misionin e KFOR-it i cili udhëhiqet nga NATO-ja. Në këtë mision aktualisht janë



rreth 4 700 ushtarë. Prej tyre kontingjentin më të madh e ka Italia me 1 250 pjesëtarë, pasi e ka edhe komandën, ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë rreth 600 pjesëtarë në këtë mision.

Kjo vizitë e shefit të NATO-s pritet të bëhet në kohën e raporteve të tensionuara në mes të Evropës dhe ShBA-së, pas hapave të ndërmarrë nga administrata amerikane me Rusinë për t'i dhënë fund

luftës në Ukrainë.

Shtetet e Bashkuara bënë trysni mbi presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky për t'u pajtuar me thirrjen e Uashingtonit për një marrëveshje që do t'u jepte fund luftimeve në Ukrainë, ndërkohë që udhëheqësit evropianë kërkuar një rol më të fortë në këtë qëllim.

Trumpi tha se durimi i tij është drejt fundit dhe kritikoi rezistencën e Zelenskyt ndaj

perspektivës së një armëpushimi të shpejtë, pa garanci konkrete të sigurisë, që Kievi i kërkon nga Shtetet e Bashkuara.

Kryeministri britanik Keir Starmer dhe presidenti francez Emmanuel Macron kanë thënë se janë të gatshëm të dislokojnë trupa në Ukrainë për të ndihmuar në ruajtjen e paqes, në rast se nënshkruhet një marrëveshje për t'i dhënë fund luftës që nisi më 2022.

## REAGIM I KËSHILLIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE TË LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

# Sonny Playstation i Gjykatës Raciste Speciale

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, bëri kërkesë për herë të katërt që t'i lejohet vizita humanitare për ta vizituar babanë e sëmurë dhe të moshuar. Arsyetimi i GJRS ishte në kundërshtim të plotë me të drejtat e personave të privuar nga liria e që garantohen me të gjitha dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Presidenti, Hashim Thaçi ishte në dy vizita humanitare në Kosovë duke respektuar me përpikëri kushtet e përcaktuara nga kjo Gjykatë për vizitat e tilla. Nuk ishte regjistruar asnjë shkelje nga z. Thaçi që do të përdorej si arsyetim për refuzim të kërkesës. Haxhi Thaçi, 86-vjeçar babai i presidentit Thaçi ishte pranuar në QKUK për shkak të gjendjes së përkeqësuar shëndetësore. Autoritetet shëndetësore të QKUK-së kanë dërguar dëshmi për gjendjen shëndetësore të babait të presidentit por se nuk ishin marrë parasysh nga GJRS-ja. Si alternativë, GJRS-ja kishte propozuar që Hashim Thaçi ta "vizitojë" babanë përmes video lidhjes thauja së 86-



vjeçari na qenka ekspert për këso biseda ndonëse është në moshë të shtyrë dhe i sëmurë rëndë. Ngjashëm pati vepruar edhe me rastin e vdekjes së vëllait të Nasim Haradinajt kur nuk e lejuan të marrë pjesë në ceremoninë mortore. Me këto veprime çnjerezore, GJRS-ja po i shkelë brutalisht të drejtat e njeriut ndonëse botërisht deklaroi se në të drejtat e personave të personave të

privuar nga liria ka integruar standardet më të larta të Kombeve të Bashkuara të njohura si Rregullat e Nelson Mendelës. Gjykata Speciale deklarohet se është pjesë e sistemit të drejtësisë të Kosovës ndonëse me asgjë nuk i përgjigjet këtyre institucioneve dhe nuk ka asnjë shenjë identifikuese të Republikës së Kosovës me të cilën nuk bashkëpunon për asgjë përveçse i arreston dhe

dënon shtetasit e Kosovës ndërsa bashkëpunimin e ka kryesisht me Serbinë. Kjo gjykatë nuk monitorohet nga askush sikur që nga pushteti aktual i Kosovës i ka duart e lira të bëjë ç'të dojë me të privuarit nga liria, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës. KMDLNj ka kërkuar dhe kërkon të bëhet një auditim i pavarur ndërkombëtar për punën e kësaj gjykate pasi për shkak të

mungesës së monitorimit të pavarur dhe mungesës brutale të transparencës, kjo gjykatë po i shkelë të gjitha të drejtat e njeriut të personave të akuzuar dhe të dënuar, të gjithë shqiptarë dhe shtetas të Kosovës. Rastin e presidentit Hashim Thaçi duhet ta trajtojë me urgjencë Komiteti Ndërkombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Degradues i Kombeve të Bashkuara pasi hynë në juridiksionin e pranuar ndërkombëtar të këtij Komiteti.

KMDLNj e dënon ashpër dhunën psikologjike dhe brutalitetin refuzues të kësaj Gjykate për rastin e presidentit Thaçi. Gjykata Raciste Speciale përveçse është e shkëputur nga ndjenja humanitare, ashpërsisht dhunon edhe kontekstin tradicional të Kosovës e respektimit të familjes. Çdo institucion mbajtës në botë i kushton shumë rëndësi ruajtjes së shëndetit social të personave të privuar nga liria. GJRS-ja nuk i përmbahet kësaj norme ligjore dhe morale. Përkundrazi, e shpërfillë egërsisht.



# KURTI SHPËRFILL URDHRIN E GJYKATËS THEMELORE, S'PARAQITET NË PROKURORI PËR DËSHMI

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, përsëriti të martën se është i gatshëm të dëshmojë në rastin e rezervave shtetërore dhe i ftoi sërish hetuesit e Prokurorisë Speciale që të shkojnë në zyrën e tij. Kurti i bëri komentet në Gjilan, ku mori pjesë në vendosjen e gurthemelit të një kopshti për fëmijë. Në kohën që ishte atje, përkatësisht në 10:00 të paradites, ai ishte i ftuar të paraqitej në Prokurorinë Speciale të Kosovës, me urdhër nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Megjithatë, Kurti nuk u paraqit atje

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 4 MARS** - Kryeministri Albin Kurti ka shpërfillur urdhrin e Gjykatës Themelore që të paraqitet në Prokurorinë Speciale për intervistim në cilësinë e dëshmitarit. Kurti pikërisht në orën 10:00, kur i ishte caktuar për të dhënë dëshmi në Prokurori, vendosi të merrte pjesë në vendosjen e gurthemelit të një çerdhe në Gjilan. I pyetur nga gazetarët se përse nuk respektoi urdhrin e gjykatës, kryeministri u shpreh se "mirëpret prokurorinë në zyrën e kryeministrit". "Së pari unë asnjëherë nuk kam thënë që nuk do të jap dëshmi, ose

refuzoj të jap dëshmi. Përkundrazi, kam thënë se jam jo vetëm i gatshëm, por edhe i interesuar. Në anën tjetër kam shkruar letrën në të cilën kam treguar oraret se ku mund të bëhet dëshmia. Unë e mirëpres prokurorinë në Zyrën e Kryeministrit. Ka pasur raste në të kaluarën kur prokurorët - hetuesit - kanë ardhur për kryeministria jo vetëm si dëshmitar, por edhe të pandehur, prandaj nuk ka ndonjë arsye që të mos vazhdohet", ka thënë Kurti para medieve në Gjilan. Kryeministri nuk ka kursyer sërish akuzat ndaj Prokurorisë Speciale dhe medieve, duke thënë se qëllimi i Prokurorisë

nuk është luftimi i krimit dhe korrupsionit, por i qeverisë. "Qysh në muajin dhjetor ka qenë e mundur që të kryhet ky intervistim. Nëse Prokuroria e ka pasur shumë të rëndësishme dëshminë time, ajo do të vinte te ne. Një prokuror që ka synim kryesor dëshminë e dëshmitarit ai nuk humbet kohë. Shtrohet pyetja pse Prokuroria i humbet tre muajt! Për bindjen time është më shumë e interesuar t'i mbush ballinat e ndonjë portali të oligarkut sesa të sjellë drejtësi. Kurrë Prokuroria e Shtetit në Kosovë nuk ka qenë më e lirë për të vepruar. Fatkeqësisht, lirinë po e keqpërdor për ta luftuar

qeverinë e jo krimin e korrupsionin. Unë theksoj se gjithmonë kam qenë dhe jam i gatshëm të dëshmoj", ka thënë Kurti.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pas interesimit të shumë gazetarëve, ka informuar se dëshmitari A. K. (Albin Kurti, kryeministër) nuk është paraqitur në Prokurorinë Speciale për ta dhënë dëshminë e tij edhe përkundër faktit se i njëjti ka qenë i obliguar me urdhër të Gjykatës Themelore në Prishtinë që të paraqitet në cilësi të dëshmitarit, për ta dhënë dëshminë e tij më 04.03.2025, në orën 10:00, në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. "Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës edhe në këtë rast penal, sikurse në të gjitha rastet e tjera, do të veprojë duke respektuar legjislacionin në fuqi", ka njoftuar Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

(ZKPSH) kanë reaguar lidhur me deklaratën e kryeministrit Albin Kurti për mosparaqitjen e tij në Prokurorinë Speciale për të dhënë dëshmi. "Me rastin e deklaratave të sotme publike, të dhëna nga Kryeministri Albin Kurti, për mosparaqitjen e tij në Prokurorinë Speciale për të dhënë dëshmi në cilësinë e dëshmitarit, përkritazi me dyshimet për keqpërdorim të rezervave shtetërore, edhe pse Gjykata Themelore në Prishtinë kishte lëshuar urdhër për paraqitjen e tij në prokurori, Këshilli Prokurorial dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, rikujtojnë se zbatimi i ligjit nuk mund të keqinterpretohet sipas shijeve, interesave dhe nevojave ditore të Kryeministrit në detyrë, duke dhënë deklarata jashtë parimeve bazë të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës", thuhet në reagimin e KPK-së dhe ZKPSH-së.

Sipas KPK-së dhe prokurorit të shtetit këto deklarime përbëjnë vetëm pikëpamje dhe botëkuptime personale që ka

# KQZ-ja pret që sot të përfundojë numërimi i votave

PRISHTINË, 4 MARS - Zëdhënësi i Komisionit Qendror Zgjedhor, Valmir Elezi, ka thënë se pret që të mërkurën, më 5 mars, të përfundojë numërimi edhe i votave të fundit, atyre me kusht dhe të personave me aftësi të kufizuara. "Në QNR është në përfundim e sipër procesi i numërimit nga votimi jashtë vendit, respektivisht votimi përmes postës. Pra gjatë ditës së sotme do ta përmbyllim procesin e numërimit të votave nga votimi jashtë Kosovës dhe, gjithashtu, në QNR ka filluar procesi i numërimit të votave me kusht, pastaj edhe votave të personave me nevoja të veçanta. Ky proces do të bëhet sot dhe presim të përfundojë nesër", ka thënë tha ai.


Elezi ka njoftuar se KQZ-ja ka pranuar një vendim nga PZAP-i për të llogaritur si të vlefshme disa fletëvotime, të cilat gjatë procesit të numërimit në QNR ishin konsideruar të pavlefshme. "Mund t'ju informoj se PZAP-i ka marrë

një vendim për të llogaritur të vlefshme disa fletëvotime të cilat gjatë procesit të numërimit në QNR janë llogaritur të pavlefshme. Si KQZ, meqenëse në këtë vendim të PZAP-it ka këshill juridike, palët mund të parashirojnë ankesë ndaj këtij vendimi në Gjykatën Supreme brenda 48 orëve. Si KQZ do të presim që të kalojë ky afat dhe pastaj do të vendosim për zbatimin e PZAP-it nëse nuk ka ankesë në Gjykatën Supreme", ka thënë Elezi.

Me rezultatet aktuale, që përfshijnë edhe votat në vendvotimet në Kosovë, ato në përfaqësitë diplomatike dhe me postë, asnjëra parti nuk ka siguruar numër të mjaftueshëm për të qeverisur e vetme.

Për ta pasur shumicën, duhen së paku 61 deputetë në Kuvendin me 120 ulëse të Kosovës. Si partia e parë, Vetëvendosje i ka aktualisht 48.

Udhëheqësi i saj, kryeministri



Albin Kurti, është zotuar se do ta formojë qeverinë në mënyrë të pavarur.

Partitë aktualisht në opozitë,

përveç Nismës, e kanë përjashtuar mundësinë e koalicionit me të.

Procesi i numërimit të votave

është në javën e katërt. KQZ-ja pritet ta bëjë certifikimin e rezultateve në mes të këtij muaji.

# Gripi i shpendëve në Durrës, AUV shton masat e kontrollit

PRISHTINË, 4 MARS - Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë ka njoftuar se ka ngritur masat e kontrollit për ngarkesat me produkte me origjinë shtazore, kafshë dhe shpezë të gjalla nga zona e Durrësit - Shqipëri.

AUV njofton se është në kontakt të vazhdueshëm me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të Shqipërisë për të marrë informacione të përditësuara mbi situatën zoonotike lidhur me praninë e gripit të shpendëve, nën tipin H5N1. Aktualisht, një fermë në afërsi të Durrësit është identifikuar si e prekur nga kjo sëmundje. "Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në bashkëpunim me autoritetet shqiptare, AUV ka vendosur masa të menjëhershme të kontrollit kufitar. Inspektorët veterinarë kufitarë janë urdhëruar të kryejnë kontrole të detajuara mbi ngarkesat me produkte ushqimore me origjinë shtazore, si dhe mbi kafshët apo shpendët e gjalla, duke zbatuar në përpikëri



procedurat e kontrollit për të parandaluar përhapjen e mundshme të sëmundjes në vendin tonë", bëhet me dije në njoftim.

Ndër të tjera, thuhet se situata e gripit të shpendëve mbetet e

kufizuar në një fermë të izoluar, ndërsa autoritetet shqiptare kanë marrë masa të menjëhershme për izolimin e zonës dhe ndalimin e qarkullimit të brendshëm. "Nuk është vlerësuar e

nevojshme vendosja e masave kufizuese për importin e përgjithshëm, pasi Kosova nuk ka import të shpendëve të gjalla nga kjo zonë. Aktualisht, rreziku i përhapjes së gripit H5N1 përmes importit mbetet i ulët.

Megjithatë, AUV është në gjendje gatishmërie dhe do të përshtatë masat sipas zhvillimit të situatës", theksohet në njoftim.

Më tej, bëhet me dije se fermerët që mbajnë shpendë duhet t'i zbatojnë menjëherë masat e biosigurisë në fermat e tyre për ta parandaluar përhapjen e gripit të shpendëve (Avian Influenza).

"Përmes shoqatave përkatëse, të gjithë fermerët komercialë janë njoftuar për masat mbrojtëse të biosigurisë, të cilat janë thelbësore për mbrojtjen e shpendëve të tyre. Aktivizimi i sistemit të vetëkontrollit dhe zbatimi i masave të biosigurisë në fermë janë mënyrat më efikase për të përballuar këtë sëmundje. Gripi i shpendëve përhapet kryesisht nga shpendët shtegtarë, çka e bën sfidues parandalimin e tij për çdo vend. Prandaj, bashkëpunimi i fermerëve dhe zbatimi i masave të duhura është vendimtar për mbrojtjen e fermave dhe të sektorit të shpendarisë në vend".

ai për sundimin e ligjit, sepse veprimet për zbatimin e ligjit janë detyrim jo vetëm për sistemin prokurorial, por edhe për kryeministrin, qeverinë dhe për cilindo institucion tjetër dhe qytetar të vendit. "KPK dhe ZKPSH, potencojnë se deklaratat e dhëna në vazhdimësi nga kryeministri Kurti e dëmtojnë seriozisht funksionimin e institucioneve demokratike dhe kanë për qëllim minimin e angazhimit

të Prokurorit të Shtetit në përpjekjet për forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës. Pa marrë parasysh përpjekjet për degradimin e organeve kushtetuese nga ana e kryeministrit Kurti, KPK dhe Prokurori i Shtetit inkurajojnë dhe mbështesin fuqishëm Prokurorinë Speciale për realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë ligjore të saj, siç janë hetimi, ndjekja dhe

ndriçimi i secilit rast penal që bie në kompetencë të saj, me qëllim të ngritjes së moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në vendin tonë", thuhet në reagimin e KPK-së dhe të ZKPSH-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë ka konfirmuar ditë më parë se ka lëshuar urdhër që e obligon Kurtin të japë dëshminë e tij në cilësinë e dëshmitarit, në një rast që ka të bëjë me dyshimet për

keqpërdorime me rezervat shtetërore.

Urdhri ka ardhur pasi kryeministri nuk u është përgjigjur dy ftesave që ia ka bërë Prokuroria në muajt e fundit. Vetë kryeministri ka thënë disa herë se nuk i ka refuzuar ftesat, por ka insistuar që dëshminë ta japë në zyrën e tij në Kryeministri.

Zyra e tij ka thënë, po ashtu, se i ka dërguar kërkesë Gjykatës Themelore për ta urdhëruar

Prokurorinë që ta marrë dëshminë e Kurtit në Kryeministri.

Kurti pretendon se Prokuroria ka marrë dëshmi në zyrën e kryeministrit edhe në të kaluarën - pa përmendur ndonjë emër - ndërsa refuzimin e tij për të shkuar në Prokurori e arsyeton duke thënë se nuk dëshiron të bëhet "lajm botëror" që, kinse, kryeministri po dyshohet për një rast korrupsioni.

## Në Prizren diskutohet për ndërtimin e një qendre informative në Prevallë

PRIZREN, 4 MARS - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të martën zyrtarët e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, të Administratës së Parkut

Kombëtar “Sharri” dhe sektorit për Mbikëqyrje dhe Kontroll, për t’i diskutuar mundësitë e bashkëpunimit në procesin e hartimit të Planit Hapësinor dhe Planit

Menaxhues për këtë park. Në fokus ishte ndërtimi i një qendre informative në Prevallë, në prona të komunës, si dhe ngritja e vetëdijes për ruajtjen e pasurisë natyrore

dhe përmirësimi i shërbimeve për vizitorët, që synon mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Parkut të rëndësishëm Kombëtar “Sharri”.



## Vendoset gurthemeli i çerdhes së re në Gjilan, investim i MASHTI-t në vlerë prej rreth 855 mijë eurosh



GJILAN, 4 MARS - Kryeministri Albin Kurti së bashku me ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavcin dhe kryetarin e komunës së Gjilanit, Alban Hysenin, vendosën gurthemelin e çerdhes së re në Gjilan.

Gurthemeli i çerdhes, e cila është e gjashta në komunën e Gjilanit në këtë mandat të qeverisë, arrin koston e shumës rreth 855 mijë euro. Me afër 900 metra katrorë, kjo çerdhe ka kapacitet për 80 fëmijë dhe punimet e këtij

projekti parashihen të përmbyllet për 12 muaj.

Me këtë rast tha se ky është lajm i mirë për komunën e Gjilanit, për fëmijët dhe prindërit, pasi para qeverisjes aktuale ka munguar kujdesi për fëmijët në kuptimin institucional dhe social. “Kur e kemi marrë pushtetin ekzekutiv kemi ardhur në qeverisje të këtij vendi të cilin e kemi realizuar pas fitores së madhe të shkurtit të vitit 2021. Nuk e kemi gjetur asnjë çerdhe në Gjilan të financuar nga MASHTI. Gjithashtu, kur ka

ardhur në pushtet ekzekutiv në Gjilan, Alban Hyseni, kur ka filluar qeverisja e mirë në komunën e Gjilanit, pas zgjedhjeve të vjeshtës të vitit 2021, këtu nuk ka pasur kujdes për fëmijët as në kuptimin institucional dhe as në kuptimin social. Prandaj, është ditë e lumtur për të gjithë qytetarët e Gjilanit”, tha ai. Me këtë rast, kryeministri i përgëzoi qytetarët, deputetët e pranishëm dhe aktivistët për këtë ditë të shënuar në vendosjen e gurthemelit për çerdhen e gjashtë në komunën e Gjilanit.

## Latifi nënshkruan marrëveshje për rritjen e kapaciteteve profesionale në administratën komunale dhe në arsim

RAHOVEC, 4 MARS - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me drejtorin ekzekutiv të Institutit KAF, Bujar Krasniqi, që parasheh rritjen e kapaciteteve profesionale në administratën komunale

dhe në arsim. “Ky bashkëpunim sjell trajnime të specializuara për menaxhimin e financave publike dhe transparencën financiare, për auditimin dhe për menaxhimin e riskut, si dhe programin ‘BEINT - Shkolla e

Drejtorëve’, për përmirësimin e cilësisë në shkolla. Me këtë hap, po investojmë në burimet njerëzore, si themel për një administratë publike më efikase dhe për një sistem arsimor më të fortë në Rahovec”, ka njoftuar Latifi.



## Prishtina nis digjitalizimin e shkollave

PRISHTINË, 4 MARS - Komuna e Prishtinës ka nisur zyrtarisht procesin e digjitalizimit në shkollat publike, duke e shënuar fillimin e këtij projekti me një ceremoni në shkollën fillore “Dardania”.

Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, njoftoi se deri në fund të vitit të gjitha klasat në kryeqytet do të pajisen me sisteme digjitale, përfshirë panele interaktive dhe qasje në kurrikulën digjitale. “Kemi filluar instalimin e paneleve digjitale në shkollën ‘Dardania’



dhe po vazhdojmë me shtatë shkolla të tjera. Synimi ynë është që deri në fund të vitit t’i instalojmë në të gjitha klasat. Tashmë të gjithë nxënësit kanë qasje në kurrikulën digjitale, e cila i lehtëson ndjeshëm sfidat me të cilat janë përballur më parë”, tha Rama.

Përveç paneleve digjitale, kryetari i Prishtinës bëri me dije se projekti përfshin integrimin e Intelgjencës Artificiale në procesin mësimor dhe vendosjen e sensorëve për monitorimin e cilësisë së ajrit në

klasat shkollore. “Jemi duke punuar që të integrojmë Intelgjencën Artificiale si pjesë të sistemit arsimor në kryeqytet. Po ashtu, në të gjitha shkollat synojmë të instalojmë sensorë që do të monitorojnë cilësinë e ajrit, për të siguruar kushte optimale për nxënësit”, shtoi ai. Rama e cilësoi këtë nismë si një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të arsimit në Prishtinë, duke premtuar që ky transformim teknologjik do të ndikojë pozitivisht në cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies.

## Paraqitet master-plani për rigjenerimin e Kodrës së Trimave

Prishtinë, 4 mars - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka paraqitur të martën para qytetarëve master-planin për rigjenerimin e Kodrës së

Trimave. Sipas tij, ky është një projekt vizionar që synon zhvillimin e lagjes dhe krijimin e një hapësire urbane moderne. “Gjatë takimit,

dëgjuam edhe mendimet e qytetarëve, duke marrë parasysh shqetësimet dhe idetë e tyre për ta bërë këtë projekt sa më të qëndrueshëm

dhe funksional për komunitetin. Ky është një hap i rëndësishëm për të ardhmen e qytetit tonë!”, ka shkruar Rama në “Facebook”.



# Në Shqipëri dyfishohen votuesit nga jashtë, Celibashi: Vota e tyre do të ndikojë në rezultat

**TIRANË, 4 MARS** - Në Shqipëri regjistrimi i votuesve nga jashtë vendit, një proces që kryhet për herë të parë, ka shkuar sa dyfishi i parashikimeve, ndërsa KQZ-ja i kërkoi qeverisë ta shtojë buxhetin mbi shërbimet postare për shpërndarjen e fletëve të votimit. Për zgjedhjet e përgjithshme të 11 majit janë regjistruar deri tani 51 subjekte politike, që duhet t'i dorëzojnë brenda 10 ditësh listat e kandidatëve për deputetë.

Komisionari Shtetëror i Zgjedhjeve, Ilirjan Celibashi, u ka kërkuar mirëkuptim partive politike, që KQZ-ja të ndihmojë për disa ditë gjatë riaplikimit edhe 42 mijë shqiptarëve që u është refuzuar kërkesa e parë për votim.

Një ditë para skadimit të afatit mbi kërkesat nga diaspora, që shqiptarët të votojnë nga jashtë vendit në zgjedhjet e përgjithshme të 11 majit, numri i refuzimeve prej mungesave në dokumente është sa një e pesta e pranimeve. Megjithatë kërkesat e miratuara deri tani

janë më shumë sesa dyfishi i parashikimit më optimist të fillimit, dhe nevojitet tashmë edhe dyfishimi i buxhetit për t'i postuar fletët e votimit drejt çdo adrese votuesi, një shtesë që shpresohet se do të dalë brenda kësaj jave. "Nuk ka asnjë hezitim nga ministria e Financës, nga qeveria, për ta mbështetur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për sa i përket këtij aspekti. Besoj që do të qëndrojmë te një llogari, që merr në konsideratë numrin prej 250 mijë votuesish nga jashtë", tha komisionari shtetëror i Zgjedhjeve, Ilirjan Celibashi.

Duke filluar nga 11 janari, kur nisi procesi, kërkesat për regjistrim nga jashtë vendit janë mbi 273 mijë, nga këto janë miratuar mbi 220 mijë, dhe janë refuzuar mbi 42 mijë. Komisionari shtetëror i Zgjedhjeve, Ilirjan Celibashi, thotë se më 9 mars del lista e votuesve nga jashtë vendit, ndërsa ka kërkuar mirëkuptimin e partive politike që gjatë kësaj kohe të bëhet gjithçka nga KQZ-ja që të ulët sa më shumë numri i kërkesave të refuzuara, duke i



ndihmuar qytetarët nga jashtë në procesin e riaplikimit. "Nëse ne ia dalim që këtë numër prej 42 mijë zgjedhësish ta trajtojmë, nëse do të kenë interes për të aplikuar, në mënyrë individuale, sikurse kemi disa ditë që po e bëjmë këtë, besoj se do të ishte me dobi. Por edhe për këtë duhet konsensusi i forcave politike, sidomos i dy partive kryesore politike", tha Celibashi. As këtë radhë votimi dhe numërimi elektronik nuk do të

ketë ndonjë përhapje të gjerë, përveç dy qendrave për qëllime studimi, si njësia 10 e bashkisë së Tiranës dhe në bashkinë e Vorës. Tashmë ka skaduar afati për regjistrimin e koalicioneve politike, ndërsa në zgjedhje janë regjistruar të garojnë 51 subjekte politike, dhe po shqyrtohen edhe dy kërkesa të tjera, ndërsa për listat me emrat e kandidatëve afati i fundit është 12 marsi. Celibashi thotë se votat nga jashtë mund të ndikojnë mbi

një numër të konsiderueshëm, deri në një të pestën e mandateve në Kuvend. "Janë numrat shumë të mëdhenj të votuesve nga jashtë dhe besoj se do të kenë ndikim në rezultatin e zgjedhjeve. Matematikisht janë 23-25 mandate që mund të ndikohen prej votave nga jashtë", thotë Celibashi.

Operatorë të njohur ndërkombëtarë të postave kanë përfaqësi në Shqipëri dhe ata do të ftohen për t'i shqyrtuar ofertat, ndërsa posta shqiptare është përjashtuar me ligj nga këto procedura. Atyre do t'u kërkohet që fleta e votimit të mbërrijë sa më shpejt dhe personalisht në dorën e çdo votuesi të regjistruar dhe me një çmim sa më të ulët.

Ndërkohë subjektet kryesore politike kanë nisur tubimet me mbështetësit e tyre brenda dhe jashtë vendit për të zgjedhur më 11 maj nëse socialistët do të kenë një mandat të katërt në qeverisje, dhe nëse demokratët do ta arrijnë rotacionin pas më shumë se një dekade në opozitë.

## Regjistrohen disa raste me fruth në Kosovë, IKShPK-ja bën thirrje të vaksinohen fëmijët

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 4 MARS** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) u ka bërë thirrje prindërve t'i vaksinonjë fëmijët kundër fruthit, shytave dhe rubellës. IKShPK-ja ka njoftuar se gjatë këtij viti janë regjistruar disa raste sporadike me fruth në vendin tonë. "Në kuadër të mbrojtjes së shëndetit publik dhe me qëllim të parandalimit të përhapjes së sëmundjeve ngjitëse dhe ruajtjes së shëndetit të fëmijëve, është shumë e rëndësishme që të siguroheni që fëmijët e juaj të jenë të vaksinuar me vaksinat MMR (fruthi, shytat dhe rubella). Gjatë këtij viti



(periudha janar-mars 2025) janë regjistruar disa raste sporadike me fruth në vendin tonë, ndërkohë që vakcina mbetet mënyra më e sigurt për parandalimin e rasteve të reja", thuhet në njoftim.

IKShPK-ja ka dhënë edhe informacione për vaksinën MMR që merret në këto raste. "Vaksina MMR jepet për të parandaluar fruthin, shytat dhe rubellën. Ajo është e sigurt dhe e efektshme dhe

është një nga mënyrat më të mira për të mbrojtur fëmijët nga këto sëmundje. Kur duhet të vaksinohen fëmijët? Vaksina MMR, sipas Kalendarit të rregullt të vaksinimit, jepet në dy doza: Doza e parë në moshën 12-15 muaj dhe doza e dytë në moshën 5-6 vjeç", ka njoftuar IKShPK-ja.

IKShPK-ja thekson se fëmijët të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë arritur ta marrin vaksinën sipas Kalendarit të rregullt, mund të vaksinohen në çdo kohë, duke qenë se vakcina mund të jepet edhe pas moshës gjashtë vjeçe. "Është e rëndësishme që fëmija ta kompletojë serinë e vaksinimit duke i marrë të dy dozat e vaksinës MMR, për ta

siguruar mbrojtjen e plotë", ka njoftuar Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.

IKShPK-ja thekson tutje se për shkak të rasteve të fundit të fruthit në vend dhe në shtetet fqinje, është thelbësore që çdo fëmijë të jetë i vaksinuar, për të parandaluar shpërthime të mundshme dhe për ta siguruar shëndetin e tyre dhe të fëmijëve të tjerë. "Vizitoni Qendrën e Mjekësisë Familjare më të afërt, aty mund ta vaksinoni fëmijën. Të gjithë fëmijët që janë të vaksinuar me vaksinat MMR janë të mbrojtur nga këto sëmundje ngjitëse, dhe ndihmojnë kështu në parandalimin e përhapjes së tyre", thuhet në njoftimin e IKShPK-së.

## Maqedonci me ambasadorin britanik flasin mbi forcimin e bashkëpunimit dypalësh

**PRISHTINË, 4 MARS** - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Kosovës, Jonathan Hargreaves, me të cilin kanë diskutuar mbi forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Gjatë takimit një nga çështjet kryesore të diskutuara ishte

arkitektura e re politike në botë dhe sfidat që vijnë me të. Palët dhanë ide dhe qasje mbi mënyrat më efektive për t'i përballuar zhvillimet e fundit globale, duke theksuar rëndësinë e koordinimit dhe partneriteteve strategjike. Ambasadori Hargreaves i përcolli ministrit Maqedonci urimet më të sinqerta për rezultatin e zgjedhjeve, duke vlerësuar leadershipin dhe

angazhimin e tij në forcimin e sektorit të mbrojtjes. Gjithashtu, ai shprehu gatishmërinë për të vijuar dhe thelluar bashkëpunimin në mes të dy vendeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Të dyja palët riafirmuan angazhimin për të punuar së bashku në forcimin e sigurisë dhe stabilitetit, duke eksploruar mundësi të reja për bashkëpunim në të ardhmen.



## Peci thotë se eksportimi i domates ka shënuar rritje 2 048 për qind

PRISHTINË, 4 MARS - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka bërë me dije se ka pasur rritje të eksportit të domates deri në 2 048 %. Peci në "Facebook" ka shkruar se në vitin 2021 eksporti i domateve në peshë ishte 135 tonë, ndërsa në vitin 2024 ka arritur një shifër mbresëlënëse prej 2900

tonësh. "Kjo ka sjellë një rritje të jashtëzakonshme prej 2048 %. Përmes programeve për zhvillim rural, kemi mbështetur ngritjen e rreth 60 ha me sera të reja, në vlerë prej 13 milionë e 758 mijë e 452 eurosh", ka shkruar Peci. Ministri Peci ka theksuar se ky sukses është një pasqyrim

i mbështetjes së vazhdueshme të qeverisë e cila ka krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, si dhe angazhimit dhe punës së palodhur të fermerëve tanë, të cilët po japin maksimumin për të sjellë prodhime cilësore dhe për të ndihmuar në rritjen e eksporteve të Kosovës.



## Maqedonia e Veriut gjen bakter në një mostër uji nga Kosova

PRISHTINË, 4 MARS - Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë e Maqedonisë së Veriut tha se është duke inspektuar të gjitha dërgesat e ujit të importuar burimor nga Kosova, pasi analizat laboratorike zbuluan praninë e bakterit koliform në një mostër uji nga shteti fqinj, raporton Shërbimi maqedonas i "Radios Evropa e Lirë".

Disa medie në këtë vend publikuan edhe vendimin e agjencisë, sipas të cilit "bëhet fjalë për mostra të ujit "Rugove".

"REL"-i në Prishtinë kontaktoi pronarin e kësaj kompanie, Visar Kelmendi, i cili tha se shitjet në Maqedoninë e Veriut janë duke vazhduar. "Ka qenë një problem që dy-tri javë me një provë të analizës... Pastaj janë

marrë edhe dhjetë analiza të tjera të ujit në Maqedoni të Veriut, në Kosovë dhe në një shtet të tretë dhe është konfirmuar se nuk ka asgjë", tha Kelmendi.

"REL"-i kontaktoi edhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në Kosovë në lidhje me këtë rast dhe është në pritje të përgjigjes.

Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë në Shkup tha se "nga secila dërgesë e ujit burimor dhe pijeve joalkoolike me origjinë nga Kosova do të merren mostra laboratorike për testimin e mikroorganizmave në përputhje me Rregulloren për kërkesat specifike që kanë të bëjnë me kriteret mikrobiologjike për ushqim". Paralelisht, kjo agjenci tha se



Maqedonia e Veriut ka shtuar kontrollin edhe për frutat dhe perimet e importuara nga të gjitha vendet, për t'i përcjellë

mbetjet e pesticideve. Ajo tha se produktet nuk do të lejohen në treg pa i pasur rezultatet që e konfirmojnë sigurinë e tyre.

### Çka është bakteri koliform?

Bakteri koliform është organizëm i pranishëm në mjedis dhe në jashtëqitjet e të gjitha kafshëve me gjak të ngrohtë dhe njerëzve.

Bakteri koliform nuk mund të shkaktojë sëmundje.

Megjithatë, prania e tij në ujë të pijshëm tregon se organizmat që shkaktojnë sëmundje (patogjenët) mund të jenë në sistemin e ujit, thuhet në përkrahimin që bën Departamenti i Shëndetësisë i Shtetit të Uashingtonit. Sipas tij, nëse bakteri koliform gjendet në një mostër uji, operatorët e sistemit të ujit punojnë për ta gjetur burimin e ndotjes.

## Veprimi SEED + forcon strategjinë e menaxhimit të rrezikut doganor të CEFTA-s 2025-2028 në Palermo

PRISHTINË, 4 MARS - Veprimi SEED+, në bashkëpunim me Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Agjencisë Italiane të Doganave dhe Monopoleve (ADM) dhe Drejtorinë Rajonale të Sicilisë, organizoi një seminar për ekspertët e menaxhimit të rrezikut doganor të CEFTA-s. Seminari u fokusua në finalizimin e Strategjisë së Menaxhimit të Rrezikut Doganor të CEFTA-s për periudhën 2025-2028, duke integruar praktikat më të mira në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

Theksi u vendos në shfrytëzimin e teknologjisë për ta rritur efikasitetin dhe



sigurinë në lehtësimin e tregtisë, ndërkohë që administratat doganore të CEFTA-s harmonizohen me

standardet e BE-së dhe avancojnë integrimin e CEFTA-s me Bashkimin Evropian. "Menaxhimi i

rrezikut doganor luan një rol thelbësor në lehtësimin e tregtisë. Misioni ynë është të sigurojmë që, me burimet dhe mjetet në dispozicion, të mbështesim administratat doganore në rritjen e sigurisë, përmirësimin e efikasitetit dhe lehtësimin e tregtisë së ligjshme, duke minimizuar rreziqet. Së bashku, mund të vlerësojmë më mirë sfidat dhe, më e rëndësishmja, të kuptojmë se si t'i adresojmë ato. Ky është pikërisht qëllimi i Strategjisë që po zhvillojmë", ka thënë Danijela Gacevic, drejtoreshë në detyrë e Sekretariatit të CEFTA-s.

Ndërkaq drejtori i Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkomb-

bëtare, ministri Plenipotenciar, Andrea Mazzella, ka thënë se integrimi doganor i Ballkanit Perëndimor është një element kyç për ta nxitur stabilitetin dhe përparimin ekonomik, duke theksuar se ADM është e përkushtuar ta koordinojë këtë proces.

Si pjesë e programit, pjesëmarrësit vizituan Zyrën Doganore të Palermos, ku panë nga afër përdorimin praktik të pajisjeve skaner dhe laboratorin kimik të operuar nga ADM, duke marrë njohuri të vlefshme mbi teknikat e avancuara të kontrollit doganor dhe inspektimit e bazuara në rrezik.

## Dogana e Kosovës zbulon 20 885 euro të falsifikuara

PRISHTINË, 4 MARS - Në kuadër të kontrolleve të rregullta të kryera nga zyrtarët doganorë në Qendrën Postare Transitore, duke përdorur pajisje të teknologjisë së avancuar si X-Ray, u zbuluan para të

dyshuara si të falsifikuara. "Gjatë kontrollit u gjetën këto sasi të dyshuara: 500 euro - 1 copë. 200 euro - 1 copë. 50 euro - 101 copë. 20 euro - 1 copë. 5 euro - 1 copë. Sasia e përgjithshme e parave të

dyshuara arrin në 20,885.00 euro. Për shkak të dyshimeve për falsifikimin e monedhave, ky rast është raportuar në Policinë e Kosovës për trajtimin e mëtejshëm në përputhje me procedurat ligjore. Autoritetet

doganore do të vazhdojnë të bashkëpunojnë me Policinë për të zbardhur plotësisht këtë rast dhe për të parandaluar aktivitetet e paligjshme të falsifikimit të monedhave", ka njoftuar Dogana.





# MËSUAM SHUMË PËR POLITIKËN DUKE FOLUR PËR... UJQËRIT



Michelle NIJHUIS dhe  
Callie HANSON

Nëse ngjani si shumë amerikanë këto kohë, nuk jeni thjesht në mosmarrëveshje me kundërshtarët tuaj politikë. Ju nuk u besoni fare, nuk i pëlqeni apo madje edhe u frikësoheni atyre. Ky “polarizim afektiv”, siç e quajmë shkencëtarët socialë, është rritur në Shtetet e Bashkuara që nga vitet 1980 dhe është jashtëzakonisht i vështirë për t’u zhbërë. Por mund të trajtohet. Kemi parë që është e mundur. Në Perëndimin rural, ku punojmë si gazetarë, pak çështje janë më polarizuese se sa rikthimi i ujqërve. Gjatë tre dekadave të fundit, numri i ujqërve në Shtetet e Bashkuara është rritur nga më pak se 300 në gati 8,000, falë ripopullimit në Parkun Kombëtar Yellowstone dhe gjetkë, ligjeve mbrojtëse dhe vetë aftësisë së ujqërve për t’u përshtatur. Për disa, popullatat e zgjeruara të ujqërve gri në Perëndim dhe Mesperëndim, së bashku me ringjalljen e ujqërve të Kuq në Juglindje, përfaqësojnë një fitore të jashtëzakonshme të mbrojtjes së natyrës. Për të tjerët, ujqërit përfaqësojnë një

kërcënim për bagëtitë, jetesën e fermerëve dhe mënyrën e jetesës në tokë. Me kaq shumë gjëra në lojë, debatet rreth menaxhimit të ujqërve janë të ashpra dhe të thella, ndonjëherë edhe të dhunshme. Tensionet janë përhapur madje edhe në verilindje, ku ujqërit janë të rrallë ose inekzistentë, por mund të ripopullohen me kalimin e kohës.

Kur na ftuan të merrnim pjesë në një event të quajtur Biseda e Ujqërve, ishim të intriguar, por skeptikë. Një bisedë rreth ujqërve? Një debat i nxehtë dukej më i mundshëm.

Biseda filloi duke shmangur me qëllim temën kryesore. Personi që drejtonte bisedën, Francine Madden, u kërkoi 25 pjesëmarrësve të mbledhur në Tucson muajin e kaluar që fillimisht të ndanin vetëm emrat e tyre. Mbetëm pothuajse gjysmë ditë në një marrëdhënie gjysmë-anonime, duke shkëmbyer përshëndetje të sikletshme gjatë vakteve dhe ndërsa zgjidhnim produktet e freskëta të një ferme vendase, e cila i dhuronte ushqimet e saj për njerëzit në nevojë.

Me marrëdhëniet e krijuara në mënyrë të brishtë, më në fund zbuluam identitetet tona të plota. Ndër ne kishte shkencëtarë, pronarë fermash

dhe tokash, zyrtarë qeveritarë, konservatorë të natyrës, aktivistë për të drejtat e kafshëve, gjuetarë dhe drejtues agjencish të jetës së egër. Në grup kishte edhe një etikist, roli i të cilit ishte të përfaqësonte perspektivën morale të ujqërve.

Mësuam se shumë prej nesh ishin të lodhur dhe të zhgënjyer pas viteve plot me ngacmime – ndonjëherë edhe kërcënime të drejtpërdrejta – nga kundërshtarët tanë, dashamirës të ujqërve ose të dyja palët. Disa kishin kaluar dekada të tëra duke u shqetësuar për bagëtitë e tyre të vrara nga ujqërit; të tjerë kishin luftuar për të mbrojtur ujqërit nga gjuetia njerëzore. Dhe kjo bëri që dyshimet tona për procesin të ishin të thella, duke qenë se përpjekjet e mëparshme për pajtim shpesh kishin përfunduar në fjalë boshe ose në mosmarrëveshje edhe më të mëdha.

Megjithatë, duke zbuluar fillimisht atë që na bashkonte para se të trajtonim atë që na ndante, arritëm të mbanim polarizimin afektiv nën kontroll. Kjo na çliroi për të shprehur mendimet tona pa frikën e sulmeve personale – dhe për të dëgjuar me vëmendje perspektivat e tjera. Gjatë ditëve që pasuan,

diskutuam përvojat tona personale me ujqërit dhe politikën e lidhur me ta. Dallime të mëdha dolën në pah, por po ashtu edhe pika të përbashkëta. (Studiuesit raportojnë se, edhe pse amerikanët janë të polarizuar në mënyrë afektive dhe ky polarizim po rritet, ne jemi më pak të ndarë politikisht sesa mendojmë: e urrejmë kundërshtarin tonë, por nuk jemi aq kundër tij sa mendojmë.)

Madden, e cila ka ndihmuar në zbutjen e mosmarrëveshjeve të vështira për mbrojtjen e natyrës në mbarë botën, theksoi se qëllimi i një bisede të tillë nuk është as eliminimi i konfliktit dhe as detyrimi për kompromis. Qëllimi është të ndryshohet natyra e konfliktit, duke e shndërruar atë nga një bllokadë pa zgjidhje, në një përpjekje të qëndrueshme.

Edhe pse një transformim i tillë nuk mund të ndodhte gjatë atyre pak ditëve tona në Tucson, ne pamë potencialin. Gjatë pushimeve nga diskutimet formale, pjesëmarrësit shpesh kërkunin të flisnin me ata me të cilët kishin më shumë mosmarrëveshje, duke treguar dëshirën për të

vazhduar dialogun. Në mbrëmjen e fundit, dy fermerë të rinj dhe etikisti u ulën nën yje, të zhytur në një debat të ashpër, por miqësor mbi vlerën e qenësishme të ujqërve. Ata nuk arritën një përfundim, por ranë dakord të vazhdojnë bisedën, dhe kjo ishte një fitore në vetvete.

Që nga takimi në Tucson, pjesëmarrësit janë zhytur sërish në polemika të njohura dhe probleme të reja – përfshirë mundësinë e shkurtimit të fondeve federale për programet që mbështesin jetën e egër dhe komunitetet rurale. Ndërkohë, zyrtarët e Colorado Parks and Wildlife kanë lëshuar 15 ujqër gri në Malet Shkëmbore Jugore, si pjesë e një përpjekjeje ripopullimi që u miratua me rezultat të ngushtë nga votuesit e shtetit në vitin 2020.

Ujqërit tani po gjejnë një mënyrë për të mbijetuar në një shtet të ndarë dhe në një komb të ndarë. Ashtu si njerëzit përreth tyre, ata janë të zgjuar dhe të adaptueshëm, dhe shanset e tyre për të mbijetuar janë mjaft të mira. Por perspektivat e tyre – dhe tonat – do të ishin shumë më të mira nëse do të arrinim të krijojmë një terren të përbashkët. / The Washington Post – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

# Sport



## Tërhiqet shorti për gjysmëfinalen e Kupës

**PRISHTINË, 4 MARS** - Në ambientet e Federatës së Futbollit të Kosovës është hedhur shorti për ndeshjet gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll. Katër

skuadra të mbetura janë: Drita, Prishtina, Llapi dhe Drenica që për synim kanë ta fitojnë trofeun e çmuar. Padyshim që dueli kryesor do të zhvillohet mes dy

skuadrave të mëdha, Prishtinës dhe Dritës. Sfidat tjetër është ajo në mes të Llapit dhe Drenicës. Nga kjo fazë e garave ndeshjet do të zhvillohen me sistem vajtje-

ardhje. Ndeshjet e para zhvillohen më 9 prill dhe ato të kthimit më 23 prill. Fituesi i Kupës së Kosovës do ta sigurojë plasmanin në rrethin e parë të Ligës së Evropës.



## Sonte katër ndeshje interesante në Ligën Unike

### “Epoka e re”

**PRIZREN, 4 MARS** - Të mërkurën zhvillohen katër ndeshjet në kuadër të javës së katërt të Ligës Unike Meshkujt, në Grupin A dhe B. Bashkimi - Besëlidhja është një sfidë interesante në Prizren, ku të dy skuadrat luajnë për fitore. Prizrenasit kanë një fitore e dy humbje, derisa Besëlidhja tri fitore dhe një humbje. Tri fitore dhe një humbje ka edhe Vëllaznimi, që pret në Gjakovë, Teutën e

Durrësit. Ndërkohë, skuadra dursake ka tri humbje në tri ndeshje. Në Grupin B, Tirana ndeshet me Golden Eagle Yllin. Takimi pritet të jetë interesant, duke marrë parasysh se të dyja skuadrat kanë nga dy fitore dhe dy humbje. Ndeshja tjetër e këtij grupi është në mes të Vllaznisë dhe Sigal Prishtinës, dy skuadra në formë të ndryshme. Shkodranët kanë një fitore dhe tri humbje, ndërsa prishtinasit tri fitore dhe një humbje. Dy skuadrat më të mira të Grupit A dhe dy më të mirat e Grupit B do

### LIGA UNIKE - JAVA 4

#### GRUPI A

Të mërkurën takohen:  
19:00 Bashkimi-Besëlidhja  
19:00 Vëllaznimi-Teuta

#### GRUPI B

Të mërkurën takohen:  
19:00 Tirana-Golden Eagle Ylli  
19:00 Vllaznia-Sigal Prishtina

të kualifikohen në Final 4, që do të zhvillohet në fund të muajit mars në Kosovë.



## ‘Ylli i javës’ në Superligë, Velju: Synojmë daljen në Evropë

### “Epoka e re”

**MALISHEVË, 4 MARS** - Federata e Futbollit të Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i javës”. Ky çmim për javën e 22-të në Albi Mall Superligë i është dhënë futbollistit të FC Malisheva, Arlind Velju. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Luan Tabaku, Bujar Asllani dhe Muhamet Sylejmani. Ky komision vendosi që çmimi “Ylli i javës” për xhiron e 22-të t’i takojë Arlind Veljut, për herë të dytë në këtë edicion kampional. Velju, përpos që shënoi një gol të



bukur, u shqua me ndërhyrjet në mbrojtje, duke qenë më meritori për fitoren e FC Malisheva kundër FC Ballkani (3:1). Pasi mori këtë çmim, Velju u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës: “Jam shumë i lumtur për këtë vlerësim dhe do të vazhdoj të jap maksimumin për ekipin tim. Ishte një gol vendimtar, i cili na ndihmoi të sigurojmë tri pikë të rëndësishme. Do të vazhdojmë ta japim maksimumin në çdo ndeshje, duke u përpjekur të paraqitemi sa më mirë dhe ta arrijmë objektivin tonë. Shpresoj që do të luftojmë deri në fund për titullin kampion dhe pse jo, të sigurojmë edhe daljen në Evropë. Është kënaqësi e madhe

për mua të luaj me Malishevën dhe ëndrra ime është ta përfaqësojmë sërish klubin në garat evropiane”, ka thënë Velju për faqen zyrtare të FFK-së. “Ky çmim është një motiv shtesë për mua, për të vazhduar të punoj dhe t’i ndjek synimet e mia për të luajtur në Evropë. Shpresoj që ky sezon të jetë një nga më të mirët dhe ta arrijmë suksesin që e dëshirojmë të gjithë. Natyrisht, çdo çmim që marr është rezultat i punës së përbashkët me bashkëlojtarët dhe stafin. Shpresoj që ky të mos jetë çmimi i fundit për një lojtar të Malishevës, sepse të gjithë e meritojnë një vlerësim për përkushtimin e tyre”, ka deklaruar Velju.

## MKRS-ja i obligon federatat që 30 për qind të buxhetit ta dedikojnë për vajza dhe gra

**PRISHTINË, 4 MARS** - Pas përmbylljes së procesit të kategorizimit janë nënshkruar memorandumet e para të këtij viti ndërmjet Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe federatave sportive për zhvillimin e aktiviteteve të tyre vjetore përgjatë vitit 2025. Pas përmbylljes së procesit të kategorizimit, janë nënshkruar memorandumet e para të këtij viti ndërmjet Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe federatave sportive për zhvillimin e

aktiviteteve të tyre vjetore përgjatë vitit 2025. Memorandumet deri më tani janë nënshkruar me Federatën e Hendbollit, Karatesë, Pingpongut, Notit dhe atë të Triathlonit, të cilat i kanë kryer me sukses obligimet e tyre për harmonizimin e akteve normative në përputhje me Ligjin e ri të Sportit, me ç’rast u hapet rruga e përfitimit financiar përmes këtyre memorandumeve. Zëvendësministrja Daulina

Osmani me këtë rast i ka njoftuar federatat që sivjet është paraparë që çdo federatë ta ketë për obligim që së paku 30 % të shumës totale të përfitimit t’ua dedikojnë aktiviteteve sportive për vajza dhe gra, me qëllim të zhvillimit dhe fuqizimit të mëtejshëm të sportit femëror në vend. Buxheti vjetor i federatave është përcaktuar përmes shumëzimit të pikës nga vlerësimi në kategorizim dhe vlerësimit të pikës të përcaktuar nga MKRS-ja.



## Xhaka: E dimë se si mposhtet Bayerni

Leverkusen, 4 mars - Mesfushori shqiptar i Bayer Leverkusenit, Granit Xhaka, para duelit me Bayern Munchenin ka shprehur optimizëm se skuadra e tij mund të fitojë ndaj skuadrës "bavareze". Bayerni dhe

Leverkuseni do të takohen të mërkurën mbrëma në "Alianz Arena" në sfidën e parë të 1/8 e finales së Ligës së Kampionëve. Xhaka e pranon se skuadra kundërshtarë është favorite, por ai beson e Leverkuseni e ka armën për ta

mposhtur kryesuesen aktuale të Bundesligës. "Mendoj se ekipi që kryeson në Bundesligë duhet të konsiderohet si favorit. Nuk dua që të keqkuptohem e të mendoni se nisemi të dorëzuar. Ne i kemi armët tona për të përballuar

një ekip si Bayern Munich. E dimë se si mundën 'bavarezët'. Me dëshirë dhe uri për sukses arrihet gjithçka", ka thënë Xhaka. Ndeshja Bayern Munchen - Bayer Leverkusen fillon në orën 21:00.



## Daku: Ëndërroj Botërorin me Shqipërinë

KAZAN, 4 MARS - Mirlind Daku ka dhënë një intervistë për faqen zyrtare të Rubin Kazanit, ku ka prekur tema të ndryshme. Nga tatuazhi për transferimin në Rusi, oferta e Rubinit dhe ëndrra botërore me Shqipërinë, Daku i thotë të gjitha. "Të jem i singertë, oferta e Rubinit ishte plotësisht befasi për mua. Në fillim nuk kam ditur për interesimin e klubit, pasi agjenti im nuk më tha asgjë për këtë. Kam menduar për klube të tjera evropiane dhe nuk kam shqyrtuar opsione të tjera. Agjenti më ka treguar vetëm për ofertat nga Evropa, por kur erdhi oferta e Rubinit kam menduar se ndoshta duhet ta pranoj atë. Ndoshta do të jetë e duhura, do të më ndihmoj të bëj hapin e madh para në karrierë. Për shkak të situatës që ishte në Rusi në atë kohë, babai im ishte pak i turpëruar. E kam edhe një tatuazh për shkak të kalimit tim në Rusi, të Rubini. Ai ka folur edhe për tatuazhin që e bëri në shenjë të transferimit në Rusi", ka thënë Daku. "Shkruan 'pa rrezik, nuk ka



histori'. Do të thotë se nëse dëshiron të bësh diçka, duhet të rrezikosh dhe që pa rrezikim nuk do të ketë tregim. Ia vlen të rrezikosh për një tregim interesant. Ky tatuazh është përshkrim i transferimit tim të Rubini. Nëse qëndron ulur dhe pret që diçka të ndodhë, atëherë zgjohu dhe bëj diçka për atë. Kërko mundësitë tua. Kalimi të Rubini ishte një prej vendimeve të mia më të mira në karrierë. U jam mirënjohës presidentit, drejtorit sportiv dhe të gjithëve në klub. Nuk kam pritur se Rubini do të më

trajtojë kaq mirë, të jem i singertë. Mendohej të bëj çdo gjë për të arritur suksese të reja së bashku. Tani e di që kam miq të mirë në Rusi, që më duan dhe i dua. Kjo është e rëndësishme për mua", ka deklaruar Daku. "Shqipëria? Nëse kualifikohemi në Botëror, do të jetë ndjenja më e mirë në karrierën time në futboll. Jo të gjithë lojtarët e kanë mundësinë të luajnë në Kampionat Botëror. Nëse e arrijmë këtë, do të jetë tregim i paharrueshëm për mua", ka përfunduar Daku.

## Oklahoma mbretëron në Konferencën e Perëndimit, Golden State e Miami rikthehen te fitorja

OKLAHOMA, 4 MARS - Oklahoma është e pakapshme në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit, duke fituar 137-128 ndaj Houstonit. I jashtëzakonshëm Alexander Shai, autor i 51 pikëve. Jashtë fushës fitoi ndal Portlandit, që mundi me rezultat 119-102 Philadelphia, sfidë ku u dallua Anfernee Simons me 34 pikë. Rikthehet te fitorja skuadra e Golden State, që mundi me rezultat 119-101 Charlotten jashtë fushës. Hieldi me 22 pikë e Curry me 21 pikë u dalluan për Warriorsin, që hyjnë në zonën "play-off". Fitore të



rëndësishme për renditje korri Detroiti, që mundi me rezultat 134-106 Utah Jazzin, ku vendimtar ishte Cunninghami me 29 pikë. Zhgënjeu skuadra e Dallasit, që u mundi me rezultat 122-98 në fushën e saj nga Sacramento. Të gjithë

REZULTATET	
Charlotte - Golden State	101-119
Philadelphia - Portland	102-119
Miami - Washington	106-90
Memphis - Atlanta	130-132
Oklahoma - Houston	137-128
Dallas - Sacramento	98-122
Utah Jazz - Detroit	106-134

titullarët e ekipit mik realizuan mbi 13 pikë. Fitoi edhe Miami, 106-90 ndaj Washingtonit, ndeshje ku u dallua Adebayo me 19 pikë, ndërsa Atlanta fitoi në sekondat e fundit me rezultat 132-130 ndaj Memphis (Risacher 27 pikë).

## Marcelo: Raporti im me Ronaldon nisi me një përleshje

Braziliani Marcelo i vendosi së fundmi këpucët në gozhdë dhe tash është koha ideale për t'i rikthyer pas kujtimit. Ish-mbrojtësi i majtë karizmatik e ka dhënë së fundmi një intervistë për "RTVE", përmes së cilës e ka kujtuar nisjen e raportit me ish-

bashkëlojtarin e tij te Real Madridi, Cristiano Ronaldo. "Raporti im me Cristiano Ronaldon nisi me një përleshje në Kombëtare. Ishim duke luajtur në një miqësore mes Brazilit e Portugalisë, ndërsa i bëra shumë faulle sepse ishte

shumë i shpejtë. Ai m'u përgjigj me një bërill dhe më kapi për qafë", kujton fillimisht ish-përfaqësuesi brazilian. "Provova edhe unë ta bëja të njëjtën gjë, por ishte shumë i gjatë... pas lojës më kanë shkruar duke më thënë se Real Madridi do ta

transferonte Ronaldon pas dy muajsh. Mendova me veten: 'Ok, më duhet të largohem nga Madridi'. Por, për fatin tim të mirë, gjithçka shkoi mirë", ka shtuar Marcelo. Në "Santiago Bernabeu", Marcelo i fitoi 25 trofe duke luajtur për gati 16

sezone me fanellën e "Los Blancos". Më pas e provoi një përvojë në Greqi dhe në fund u rikthye në atdhe, për t'u pensionuar përfundimisht më 6 shkurt. Ai konsiderohet një prej mbrojtësve të majtë më të mirë në histori të futbollit.

### SHKURT

#### Hazrollaj pritët të jetë transferimi i parë i Rapidit për edicionin e ri

Sulmuesi i Malishevës, Drilon Hazrollaj, pritët të bëhet transferimi i parë i skuadrës nga Rumania, Rapid Bukuresht, për sezonin e ardhshëm, kanë raportuar mediumet rumune të martën. Hazrollaj ka një vit që është duke u përcjellë nga drejtuesit e Rapid Bukureshtit, të cilët po e shohin si përforsim të duhur për sulmin. Thuhet se Hazrollaj i ka ndërprerë negociatat që ka pasur muajin e kaluar me klube nga Polonia dhe Ukraina pasi do t'i bashkohet Rapidit. Kartoni i Hazrollajt vlerësohet 800 mijë euro, kurse këtë sezon 21-vjeçari ka shënuar 8 gola dhe ka bërë dy asistime në 23 ndeshje të luajtura. Te Rapid Bukureshti karrierë kanë bërë edhe Ermal Krasniqi e Albion Rrahmani, që tani janë pjesë e Sparta Pragës.

#### Flick kundërshton rikthimin e Neymarit te Barça

Trajneri gjerman Hansi Flick është kundër rikthimit të mundshëm të Neymarit Juniorit te Barcelona. Raportet e mëparshme sugjeruan se braziliani dëshiron të kthehet në klubin katalanas, aty ku shkëlqeu dhe fitoi shumë trofe në të kaluarën. Barcelona është e hapur për të nënshkruar nëse Neymar shënon 15 gola për Santosin deri në fund të sezonit. Megjithatë, sipas gazetës "Sport", Flick dyshon nëse Neymar ende i përmbush standardet e Barcelonës për shkak të moshës dhe gjendjes së tij fizike. Trajneri i Barçës u jep përparësi lojtarëve të rinj dhe stilit të futbollit me intensitet të lartë. Për më tepër, vihet re se rikthimi i Neymarit nuk po konsiderohet zyrtarisht nga klubi, duke treguar mungesë konsensusi brenda udhëheqësve së Barcelonës. Situata e pasigurt financiare e klubit mund të pengojë një nënshkrim të mundshëm.

#### Vinicius mohon transferimin në Arabinë Saudite: Dua rinovimin me Realin

Sulmuesi i Real Madridit, Vinicius Junior, foli në konferencë për shtyp, në prag të derbit me Atletico Madridin në Ligën e Kampionëve. Braziliani tha se shpreson që ekipi i tij të luajë një ndeshje të shkëlqyer. I pyetur për të ardhmen, Vinicius deklaroi se është i lumtur te Reali dhe pret rinovimin duke mohuar zërat për një kalim në Arabinë Saudite. "Zërat për transferim në Arabinë Saudite? Jam i qetë sepse kam kontratë deri në vitin 2027 dhe shpresoj të rinovoj sa më shpejt. Këtu jam i lumtur. Drejtohem nga trajneri më i mirë, kemi tifozët më të mirë dhe të gjithë më duan. Unë mendoj se gjyqtarët në Evropë i mbrojnë më shumë lojtarët. Nuk na pëlqen të flasim për gjyqtarët, por është e rëndësishme që ata të gjykojnë mirë", ka thënë Viniciusi.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT




# SWISS

## TAVERNA




Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



# Lumë's Details

## Estetik & Depilim




044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE  
"Ambienti" SH.A PEJË  
NR. 593  
DATA 03.03.25

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë  
Me adresë Rr. Xhem Sadrija pn, Pusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar në ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8, dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 04.03.2025, shpall konkurs të brendshëm për këto vende të punës:

### KONKURS I BRENDSHËM

**Pozita : Kontroller i brendshëm (inspektor) - 1 pozitë**

**Vendi punës : Pejë**  
**Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.**  
**Koeficienti i pagës : 2.5**

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:**

1. Obligohet që në terren të sillet korrekt dhe të mbaj uniformë dhe shenjë identifikimi të Ndërmarrjes;
2. Në baza ditore nxjerr nga CRM-ja ankesat që janë dërguar për inspektim, angazhohet drejtpërdrejt me rastin e zgjedhjes së ankesave dhe është përgjegjës për dhënien e shënimeve të duhura për zgjidhjen e këtyre kontesteve në afat sa më të shpejt;
3. Regjistron në CRM, të gjitha proqeset që i ka inspektuar sipas rregullores së punës;
4. Jep përgjegjësi për mos kryerjen e ankesave që i janë deleguar sipas CRM-së;
5. Sipas planit mujor të kontabllitit bën inspektimin, monitorimin dhe rishikimin e aktiviteteve të inkasantëve në terren se a është bërë dorëzimi i faturave të konsumatorit dhe kontrollon se a janë të gjitha faturat në rregull;
6. Në bazë të kontrollimit të gjendjes reale dhe të të gjeturave në terren, raporton tek kontabllistit me shkrim të protokolluar më numër personal dhe datë;
7. Raporton punën ditore, mujore dhe vjetore tek kontabllistit;
8. Detyrohet të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
9. Kryen edhe punë të tjera operative me urdhëresë të kontabllistit dhe ZKP-së;
10. Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

**a. Kushtet e përgjithshme :**

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetim;
- Letër motivimi;
- Kopja e letrënjohimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

**b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)**

- Shkolla e Mesme, e preferuar Diplomë Universitare;
- Njohja e punës me kompjuter;
- Aftësia të mira komunikimi;
- 1 vit përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojë nën prision, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

**Mënyra e Aplikimit:** Dokumentacioni duhet të dërgohet në e-mailin [krmambientikonkurset@gmail.com](mailto:krmambientikonkurset@gmail.com)  
Data e për aplikim është nga 04.03.2025 deri me 19.03.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Deshira Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Ismet Berisha nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u "Hamëz Cena" Damjan KK Gjakovë nga kl. 1-8.
- Egzon Berisha nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan KK Gjakovë nga kl. 1 -8.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjymnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

